



Telender

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE E EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA LIGJORE DHE TEKNIKE
SEKTORI TEKNIK

Nr. 25P37 Prot.

Tiranë, më 27.12 .2018

Lënda: Sqarim për trajtimin e shoqërive të klasifikuara nën regjimin e përpunimit aktiv (punët fason)

Drejtuar: DREJTORISË RAJONALE TATIMORE

Me qëllim sqarimin e procedurave në lidhje me unifikimin e veprimeve dhe qëndrimeve për trajtimin e shoqërive të shërbimit të përpunimit të mallrave jo-shqiptare, të klasifikuara nën regjimin e përpunimit aktiv (fason), të gjitha Drejtoritë Rajonale Tatimore duhet të kenë parasysh si vijon:

Bazuar në nenin 69 “Zbritja e TVSH-së”, të ligjit nr 92/2014 datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 1, shkronja “a” është përcaktuar se, personi i tatueshëm gëzon të drejtën që të zbresë nga TVSH-ja e llogaritur për transaksionet e tatueshme, në masën që furnizimet e mallrave dhe shërbimeve të marra përdoren nga personi i tatueshëm në funksion të veprimtarisë ekonomike që kryen, TVSH-në e paguar apo për t’u paguar në Republikën e Shqipërisë për furnizimet e mallrave dhe shërbimeve që i janë furnizuar ose do t’i furnizohen këtij nga ana e një tjetër personi të tatueshëm.

Sa më sipër, tatimpaguesi (rieksportues) është i detyruar që nga njëra anë të mbajë, të dokumentojë dhe të provojë përpara administratës tatimore sa herë që i kërkohet, të gjithë dokumentacionin për justifikimin e veprimeve ekonomike dhe transaksionet financiare dhe nga ana tjetër të mbajë dhe administrojë/regjistrojë të gjithë dokumentacionin sipas legjislacionit tatimor në fuqi lidhur me veprimtarinë përkatëse.

Shoqëritë rieksportuese që operojnë në fushën e regjimit të përpunimit aktiv, duhet të disponojnë edhe dokumentacionin specifik që i mundëson atyre kryerjen e aktivitetit në fushën e regjimit të përpunimit aktiv (fason) sikundër janë autorizimi i lëshuar nga autoriteti doganor, regjistrat e mbajtur për këtë qëllim, kontratat me nënkontraktorët.

Theksojmë se, referuar kuadrit ligjor në fuqi është e rëndësishme që midis shoqërive rieksportuese (fason) dhe nënkontraktorëve të tyre, të jetë lidhur një kontratë në përputhje me Kodin Civil dhe nënkontraktorët të jenë të pajisur me autorizimin nga autoriteti doganor. Me këtë, detyrimi që kanë rieksportuesit për sigurimin e regjimit të përpunimit aktiv (fason) në mënyre korrekte quhet i përmbushur.

Mospërbushja nga ana e nënkontraktorëve e detyrimit për t'u pajisur me autorizimin përkatës nga Drejtoritë Rajonale Tatimore, i cili ndikon në veprimtarinë e tyre, duhet të shihet i ndarë nga detyrimet e rieksportuesit (fason). Mospajisja me autorizim e nënkontraktorëve nga Drejtoritë Rajonale Tatimore, nuk mund të ndikojë në detyrimet e palës tjetër (rieksportuesit) nga pikëpamja fiskale.

Në Udhëzimin Nr. 6, datë 30.01.2015 "Për TVSH-në", i ndryshuar, neni 48 pika 1, përcaktohet se:..... "Shoqëria e përpunimit aktiv që ri-eksporton këto mallra ka të drejtë gjithashtu të zbresë TVSH-në e ngarkuar në faturën e lëshuar nga nënkontraktori për punimet e kryera në kuadër të regjimit".

Bazuar sa më sipër, në përfundim theksojme se, nëse Drejtoritë Rajonale Tatimore gjatë kontrolleve të ushtruara në shoqëritë rieksportuese (fason) konstatojnë se, janë zbatuar kushtet e përcaktura me sipër nga këto shoqëri rieksportuese (fason), mbështetur në dispozitat e legjislacionit tatimor në fuqi dhe dokumentacionin ligjor të fushës përkatëse (kontrata lidhur me nënkontraktorët dhe pajisja me autorizimin nga autoritetet doganore), nuk mund t'i heqin të drejtën e zbritjes së TVSH-së këtyre shoqërive rieksportuese (fason).

Mospërbushja nga ana e nënkontraktorit të detyrimit për t'u pajisur me autorizimin përkatës nga Drejtoria Rajonale Tatimore, mbetet në përgjegjësinë e tij (nënkontraktorit) dhe është detyrë e Drejtorisë Rajonale Tatimore të kontrollojë zbatimin korrekt të legjislacionit tatimor në fuqi.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Vasilika Vjero

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZV/DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

Xhavit Curri

